

AKT MARVESHJE

PER BASHKIMIN ME PERTHITHJE

Ne mbeshtetje te nenit 216 te Ligjit Nr. 9901 dt 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", *sot me date 20.12.2018*, lidhet kjo marveshje midis paleve:

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " L & B FRUITS 2006" sh p k me NIPT L 64613401 C, me seli ne Rruga Lushnje Fier, km 2, magazine nje kateshe Nr 3, Lushnje, e perfaqesuar nga Ortaku i vetem dhe Administratori i saj Z.Lulezim Sari, dhe

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " LULO 2006 " sh p k me NIPT K 64325602 D, me seli ne Rruga Lushnje Fier, km 2, magazine nje kateshe Nr 3 Lushnje, e perfaqesuar nga Ortaku i vetem dhe Administratori i saj Z. Lulezim Sari.

Objekti i kesaj projekt marveshje eshte

Bashkimi i shoqerive me perthithje ne perputhje me nenin 215 te Ligjit Nr. 9901 dt 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", sipas te ciles shoqeria "L & B FRUITS 2006" sh p k eshte shoqeria perthithese, dhe shoqeria "LULO 2006 " sh p k eshte shoqeria e perthithur.

Shoqerite e perthithur "**LULO 2006** " sh p k nepermjet kesaj projekt marveshjeje eshte e gateshme qe te vendose qe te gjitha pasurite, te drejtat dhe detyrimet e saj, te kalojne ne favor te shoqerise perthithese "**L & B FRUITS 2006** " sh p k, ne kembim te kuotave te kapitalit qe ajo do te zoteroje ne shoqerine perthithese "**L & B FRUITS 2006**" sh p k.

Sipas te dhenave te Regjistrimit tregtar dhe bilanceve kontabel Shoqeria perthithese "**L & B FRUITS 2006** " sh p k, ka kapital ne vleren 100 000 leke, i cili perbehet nga nje kuote ne zoterim 100% te ortakut te vetem Z Lulezim Sari, kurse shoqeria e perthithur "**LULO 2006**" sh p k ka kapital ne vleren 2.131.776 leke leke, i cili perbehet nga nje kuote ne zoterim te ortakut te vetem Z Lulezim Sari.

Ne perfundim te procesit te bashkimit me perthithje shoqeria perthithese "**L & B FRUITS 2006**" sh p k do te kete nje kapital ne masen 2,231,776 leke, i cili do te perbehet nga nje kuote ne zoterim te ortakut te vetem Z Lulezim Sari.

Selia e shoqerise se re do te jete ne adresen aktuale te sshoqerise "L& B Fruits 2006" Rruga Lushnje Fier, km 2, magazine nje kateshe Nr 3, Lushnje.

Objekti i veprimtarise se shoqerise se re eshte:

"Import - export, grumbullim, paketim, seleksionim, tregtim me shumice te fruta perimeve, transport te mallrave brenda dhe jashte vendit, prodhim, tregtim te ambllazhit per fruta perime".

Ne kushtet kur kuotat e te dy shoqerive i perkasin te njejt person nuk eshte e nevojshme te akordohet ndonje e drejte e veçante persa i takon atyre qe mund te jepen per zoteruesit e shoqerise qe perthithet.

Ky projekt bashkimi me perthithje nuk parashikohet te krijoj asnje efekt ne mardheniet me punonjesit pasi te dyja shoqerite jane ne aktivitet normal dhe nuk parashikohet ndonje ndryshim ne objektin e veprimtarise, perkundrazi, pretendohet se nga ky hap do te kete nje organizim me te mire pune qe do te sjelle si nevojte rritjen e numrit te punonjesve.

Per Shoqerine Tregtare
L&B FRUIT 2006
Ortak-i Vetem
Lulezim SARI



Per shoqerine tregtare
LULO 2006
Ortak-i vetem
Lulezim SARI

